

REZULTATET E VROJTIMIT TË
GJËNDJES FINANCIARE DHE
HUAMARRËSE TË NDËRMARRJEVE
MIKRO NË SHQIPËRI
JANAR 2018

Kliti Ceca
Elona Dushku

35 (74) 2019 MATERIAL STUDIMOR




REZULTATET E VROJTIMIT TË
GJËNDJES FINANCIARE DHE
HUAMARRËSE TË NDËRMARRJEVE
MIKRO NË SHQIPËRI
Janar 2018

Kliti Ceca
Elona Dushku

35 (74) 2019

MATERIAL STUDIMOR

BANKA E SHQIPËRISË



Kliti Ceca

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, email: kceca@bankofalbania.org

Elona Dushku

Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, email: edushku@bankofalbania.org

Falenderime: Autorët falenderojnë kolegët e Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Instatit për bashkëpunimin e frytshëm. Gjithashtu falenderojnë të gjithë pjesmarrësit e Bankës së Shqipërisë në aktivitetet ku ky material është prezantuar për komentet, sugjerimet dhe diskutimet e tyre të vlefshme.

Shënim: Mendimet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinione ose qëndrime të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

PËRMBLEDHJE	9
1. HYRJE	11
1.1 Anketa dhe qëllimi i saj	11
1.2 Metodologjia e zgjedhjes	13
2.2 REZULTATET E VROJTIMIT	15
2.1 Situata financiare e ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) dhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin në vazhdim	15
2.2 Huaja dhe përdorimi i saj	19
2.3 Marrëdhëniet e ndërmarrjeve me bankat dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen	27
SHTOJCA 1	33

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Tabela 1.	Të dhëna të përgjithshme mbi ndërmarrjet sipas numrit të punësuarve	12
Grafiku 1.	Shpërndarja e zgjedhjes (ndërmarrjeve mikro) në bazë të rretheve	14
Grafiku 2.	Shpërndarja e zgjedhjes (ndërmarrjeve mikro) në bazë të sektorëve	14
Grafiku 3.	Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017	16
Grafiku 4.	Si ka ndryshuar rezultati financiar i ndërmarrjeve mikro në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 dhe si pritet të ndryshojë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017	16
Grafiku 5.	Si kanë ndryshuar veprimtaria apo investimet e ndërmarrjeve mikro në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 dhe si pritet të ndryshojnë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017	17
Grafiku 6.	Vlerësimi i pengesave kryesore të ndërmarrjeve gjatë gjashtë mujorit të parë të 2017	18
Grafiku 7.	Burimet kryesore të financimit të ndërmarrjeve mikro	18
Grafiku 8.	Përqindja e ndërmarrjeve mikro që kanë ose jo një hua për të paguar	19
Grafiku 9.	Periudha e marrjes së huasë	20
Grafiku 10.	Burimi i fondeve të huasë së marrë	20
Grafiku 11.	Qëllimi i përdorimit të huasë	21
Grafiku 12.	Si konsiderohet huaja e marrë nga ndërmarrjet që e kanë marrë atë	21
Grafiku 13.	Koha e mbetur për të shlyer të gjithë vlerën e huasë	22
Grafiku 14.	Përcaktimi i normës së interesit në kontratën e huasë	22
Grafiku 15.	Frekuenca e shlyerjes së huasë	23
Grafiku 16.	Kolaterali i vendosur për marrjen e huasë	23
Grafiku 17.	Vlera totale e kolateralit në raport me totalin e huasë	24
Grafiku 18.	Barra e huasë ndaj totali të të ardhurave	25
Grafiku 19.	Ndryshimi i pagesës së huasë	25
Grafiku 20.	Përballimi i kostos më të lartë të shërbimit të huasë nga ana e ndërmarrjeve	26
Grafiku 21.	Pritshmëritë mbi pagesën totale të kështit të huasë	26
Grafiku 22.	Vlerësimi nga ana e ndërmarrjeve për ngarkesën e borxhit	27

Grafiku 23.	<i>Përqindjet e ndërmarrjeve mbi aplikimin apo jo të ndonjë forme financimi gjatë gjashtë mujorit të parë të 2017</i>	28
Grafiku 24.	<i>Arsyet kryesore për mosaplikimin për financim</i>	28
Grafiku 25.	<i>Përqindja e kërkesave të miratuara ose jo për hua</i>	29
Grafiku 26.	<i>Veprimet që do të kryenin ndërmarrjet nëse nuk do të financoheshin nga bankat</i>	29
Grafiku 27.	<i>Vlerësimi i procesit të marrjes së huasë nga ndërmarrjet</i>	30
Grafiku 28.	<i>Perceptimi i ndërmarrjeve mbi marrëdhënien me bankat</i>	31
Grafiku 29.	<i>Mundësia që ndërmarrja të mund të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm</i>	31
Grafiku 30.	<i>Rëndësia e marrëdhënies së bankës me ecurinë e veprimtarisë së ndërmarrjeve</i>	32

PËRMBLEDHJE

Ky raport paraqet një përmbledhje të rezultateve të marra nga Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrëse të Ndërmarrjeve Mikro, që kanë 1 deri 4 të punësuar, në lidhje me aksesin në financim, si dhe situatën financiare të këtyre ndërmarrjeve. Kjo anketë u realizua për herë të parë në qershor të vitit 2017, nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me INSTAT-in, dhe synon të japë një vështrim të përgjithshëm mbi situatën financiare të ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar), si dhe duke plotësuar informacionin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha që prej vitit 2010 janë pjesë e këtij vrojtimi¹.

Banka e Shqipërisë, duke evidentuar rolin e rëndësishëm që ndërmarrjet mikro kanë në terma të punësimit, vlerës së shtuar dhe ekonomisë në tërësi, ndërmori këtë vërtetim për të analizuar dhe vlerësuar statistikisht gjendjen financiare dhe huamarrëse të tyre, si dhe për të identifikuar problemet dhe vështirësitë që këto ndërmarrje kanë në sigurimin e fondeve. Rezultatet e marra nga ky vërtetim do t'i shërbejnë ideimit të politikave të nevojshme dhe marrjen e masave paraprake për përfshirjen e mëtejshme të këtij segmenti në sistemin financiar, duke ndikuar pozitivisht zhvillimin e mëtejshëm të tyre dhe të prosperitetit ekonomik të vendit.

Në këtë vërtetim u anketuan gjithsej 2,304 ndërmarrje mikro, të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga INSTAT, duke na dhënë një pamje të plotë për ndërmarrjet mikro në Shqipëri, gjatë gjashtëmujorit të parë të 2017, që operojnë në sektorët e industrisë, ndërtimit, tregtisë dhe shërbimeve.

REZULTATET E VROJTIMIT TREGOJNË QË:

Ndërmarrjet mikro, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, evidentojnë se **problemët kryesorë** që kanë ndikuar veprimtarinë e tyre kanë qenë: **konkurrenca, gjetja e tregjeve të reja, borxhet e pashlyera dhe aksesin në financim.**

¹ Për më shumë referojuni Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Ndërmarrjeve në Shqipëri në faqen e Bankës së Shqipërisë. https://www.bankofalbania.org/Botime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Ndermarrjeve_ne_Shqiperi/

Burimi kryesor i financimit të ndërmarrjeve mikro janë shitjet dhe fondet e veta, ndërsa huaja ka një peshë të vogël.

Vetëm 26% e ndërmarrjeve mikro kanë një hua për të paguar, ndërsa 76% e tyre raportojnë se nuk kanë.

53% e ndërmarrjeve që kanë marrë hua, e kanë marrë nga bankat, ndërsa 34% e tyre e kanë marrë huanë nga një person fizik.

Huaja e marrë është përdorur më së shumti për të përballuar shpenzimet korrente të tyre (73% e ndërmarrjeve) dhe 41% janë shprehur se e kanë përdorur për të bërë një investim afatgjatë.

55% e ndërmarrjeve shprehen se përgjithësisht nuk kanë vendosur një kolateral për huanë e marrë. Ndërsa ato që kanë vendosur një pasuri të patundshme (51% e ndërmarrjeve) kanë pohuar se vlera e kolateralit është nën 100% të vlerës së huasë.

Barra e huasë (për 55% e ndërmarrjeve) është sa 20% e totalit të të ardhurave, ndërsa për 33% të ndërmarrjeve luhet në nivelin e 20-50% e të ardhurave. Për 12% të ndërmarrjeve barra e huasë është mbi nivelin e 50-80% të totalit të të ardhurave. Përgjithësisht, barra e huasë vlerësohet relativisht e shtrenjtë.

Në lidhje me rëndësinë që kanë bankat për ndërmarrjet mikro, 60% e tyre vlerësojnë se ato (bankat) janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për ecurinë e veprimtarisë së tyre.

1. HYRJJE

1.1 ANKETA DHE QËLLIMI I SAJ

Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrëse të Ndërmarrjeve Mikro (1-4 të punësuar) ka për qëllim që të marrë informacion mbi situatën financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro në Shqipëri. Fokusi dhe marrja e informacionit mbi ndërmarrjet mikro erdhi si një domosdoshmëri për të plotësuar informacionin që merret nga Vrojtimi² mbi Gjendjen financiare dhe Huamarrësve të Ndërmarrjeve të Mëdha dhe të Mesme, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2010. Për të ruajtur konsistencën e informacionit të marrë nga ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, kemi ruajtur të njëjtën formë të anketës, në mënyrë që përgjigjet të jenë të krahasueshme dhe të plotësojnë informacionin e marrë për totalin e ndërmarrjeve.

Arsyeja e anketimit të ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) është se ato kanë një rëndësi dhe kontribut të rëndësishëm në ekonominë tonë në terma të numrit total të ndërmarrjeve, numrit të punësuarve dhe vlerës së shtuar. Të dhënat mbi ndërmarrjet në Shqipëri, bazuar në Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve, INSTAT (2017), tregojnë se ndërmarrjet mikro përbëjnë afërsisht 90% të totalit të ndërmarrjeve, punësojnë mesatarisht 35% të totalit të punësuarve dhe kontribuojnë në 16% të vlerës së shtuar (tabela 1). Kjo tregon që këto ndërmarrje janë një burim i rëndësishëm punësimi dhe vlerë të shtuar në Shqipëri, prandaj është e rëndësishme të vlerësohet aksesi dhe situata financiare e tyre. Rrjedhimisht zhvillimi i mëtejshëm i tyre do ti japë një hov edhe zhvillimit ekonomik të vendit.

² Për më shumë referojuni Vrojtimin mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e ndërmarrjeve në Shqipëri në faqen e Bankës së Shqipërisë.
https://www.bankofalbania.org/Botime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Ndermarrjeve_ne_Shqiperi/

Tabela 1. Të dhëna të përgjithshme mbi ndërmarrjet sipas numrit të punësuarve

Ndërmarrjet sipas numrit të punësuarve	(1-4) të punësuar	(5-9) të punësuar	(10-49) të punësuar	50+ të punësuar
Numri i ndërmarrjeve si % ndaj totalit të ndërmarrjeve				
2010	91%	4%	4%	1%
2011	91%	5%	4%	1%
2012	90%	5%	4%	1%
2013	89%	6%	4%	1%
2014	89%	6%	5%	1%
2015	89%	6%	4%	1%
2016	89%	6%	4%	1%
Ndërmarrjet sipas numrit të punësuarve	(1-4) të punësuar	(5-9) të punësuar	(10-49) të punësuar	50+ të punësuar
Numri i të punësuarve si % ndaj totalit të punësuarve të gjithë ndërmarrjeve				
2010	38%	8%	21%	34%
2011	37%	8%	20%	35%
2012	36%	8%	19%	36%
2013	35%	9%	18%	38%
2014	32%	8%	21%	40%
2015	33%	8%	19%	39%
2016	33%	9%	19%	40%
Ndërmarrjet sipas numrit të të punësuarve	(1-4) të punësuar	(5-9) të punësuar	(10-49) të punësuar	50+ të punësuar
Vlera e shtuar në % ndaj totalit të vlerës së shtuar të gjithë ndërmarrjeve				
2010	17%	8%	25%	51%
2011	19%	8%	26%	47%
2012	14%	8%	27%	51%
2013	15%	9%	22%	53%
2014	14%	9%	23%	53%
2015	15%	7%	23%	55%
2016	17%	7%	22%	54%

Burimi: INSTAT (2017), Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, llogaritje të autorëve.

Një faktor mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjeve është aksesimi në financim dhe gjetja e fondeve të lira për zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e investimeve. Ndërmarrjet e mëdha, në Shqipëri, si kudo në botë, e kanë më të lehtë të financojnë aktivitetin e tyre dhe të marrin më shpejt një hua, krahasuar me ndërmarrjet e mesme dhe të vogla. Në rastin e Shqipërisë, pengesat që hasin ndërmarrjet e vogla janë edhe më të mëdha, duke patur parasysh faktin që jemi një ekonomi në zhvillim

dhe ka ende shumë për të bërë në lidhje me strukturën ligjore, tatimore, të drejtat e pronës etj.

Banka e Shqipërisë, duke evidentuar rolin e këtyre ndërmarrjeve në ekonomi, si dhe për të pasur një vlerësim dhe analizë të plotë të sistemit financiar në tërësi, ndërmori këtë vërtetim, rezultatet e të cilit paraqiten në këtë raport.

Anketa³ është e organizuar dhe e konceptuar në katër rubrika kryesore. Rubrika e parë paraqet një informacion të përgjithshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe sektorin ku kjo ndërmarrje vepron. Rubrika e dytë fokusohet në ecurinë financiare të ndërmarrjeve dhe sjelljen ndaj huasë. Në vazhdim, rubrika e tretë dhe e katërt jep një pamje të përgjithshme për huatë që ndërmarrjet kanë marrë, llojin dhe kushtet e marrjes së huasë. Ndërsa në rubrikën e pestë pasqyrohet se si ndërmarrjet perceptojnë marrëdhënien e tyre me bankat dhe rolin e tyre në ecurinë e aktivitetit të ndërmarrjeve mikro.


1.2 METODOLOGJIA E ZGJEDHJES

Procesi i zgjedhjes dhe anketimi u realizua nga INSTAT-i për ndërmarrjet me 1-4 të punësuar të shpërndarë në degët: industri, ndërtim, tregti dhe shërbime. Vëllimi i popullatës së konsideruar nga INSTAT në anketim është 88,369 ndërmarrje (me 1 – 4 të punësuar), sipas sektorëve të përmendur me sipër. Mbi këtë popullatë u realizua zgjedhja prej 3,200 subjektësh, që i korrespondon një niveli gabimi prej 2%. Gjatë realizimit të anketimit në terren, vetëm 2,304 ndërmarrje iu përgjigjën plotësisht të anketës, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve, rezultuan jo aktive, të mbyllura ose refuzuan të përgjigjeshin.

Shpërndarja e zgjedhjes u krye sipas parimit të proporcionalitetit, duke ruajtur të njëjtën shpërndarje që ndërmarrjet mikro kanë në territorin e Shqipërisë. Të dhënat tregojnë që 75% e ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) janë përqendruar kryesisht në 9 rrethet kryesore: Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Berat, Lushnjë dhe Korçë; ndërsa në pjesën tjetër të rretheve janë përqendruar vetëm 25% të totalit të ndërmarrjeve mikro.

³ Një kopje e anketës gjendet në Shtojcën nr. 1.


Grafik 1. Shpërndarja e zgjedhjes (ndërmarrjeve mikro) në bazë të rretheve



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.

Ndërsa në bazë të sektorëve pjesa më e madhe e ndërmarrjeve mikro, afërsisht 90% e tyre është e përqendruar kryesisht në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve dhe më pak në sektorët e industrisë dhe të ndërtimit.

Grafik 2. Shpërndarja e zgjedhjes (ndërmarrjeve mikro) në bazë të sektorëve



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.

Përpunimi i rezultateve u realizua duke përdorur peshat e përfaqësimit të zgjedhjes nga popullata, gjë që do të thotë se rezultatet e marra dhe të prezantuara në këtë material vlejnë për gjithë popullatën e ndërmarrjeve mikro.

2.2 REZULTATET E VROJTIMIT


Rezultatet e vrojtimit janë paraqitur në pjesët në vazhdim, ku fillimisht paraqitet një përmbledhje mbi situatën financiare të ndërmarrjeve të vrojtuar. Pjesa e dytë pasqyron situatën në lidhje me huanë dhe kushtet e përcaktimit të saj, ndërsa në fund trajtohen rezultatet mbi perceptimin që kanë ndërmarrjet mikro për marrëdhënien e tyre me bankat dhe elementet që ndikojnë në këtë marrëdhënie.

2.1 SITUATA FINANCIARE E NDËRMARRJEVE MIKRO (1-4 TË PUNËSUAR) DHE PRITSHMËRITË E TYRE PËR GJASHTËMUJORIN NË VAZHDIM

Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) u realizua gjatë muajit qershor të vitit 2017, dhe kishte për qëllim mbledhjen e informacionit mbi situatën financiare të ndërmarrjeve gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2017, si dhe mbi pritshmëritë e tyre për gjashtëmuajorin e dytë të 2017.

Të dhënat e vrojtimit tregojnë se në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017, aktiviteti i tyre dhe situata financiare paraqitet si në vijim. 53% e ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) pohojnë se shitjet e tyre janë ulur gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017, 36% pohojnë se shitjet kanë mbetur të pandryshuara dhe vetëm 11% e ndërmarrjeve pohojnë se shitjet janë ulur (Grafiku 3, kolonat me ngjyrë të gjelbër). Të pyetur mbi pritjet e tyre gjatë gjashtëmuajorit të dytë të 2017, 42% e ndërmarrjeve mikro presin që shitjet të ngelin të pandryshuara, 37% presin që shitjet e tyre do të rriten, dhe 21% pohojnë se shitjet do të ulen (Grafiku 3, rombet me ngjyrë të zezë).

Grafiku 3. Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017*




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikore, Qershor 2017. Ndërmarrjet janë pyetur se si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit, si dhe si presin të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm. (1 alternativë) 1. Janë rritur (Do të rriten); 2. Janë ulur (Do të ulen); 3. Nuk kanë ndryshuar (Nuk do të ndryshojnë).

*Kolonat e gjelbra përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me situatën e shitjeve në 6 muajorin e parë të vitit 2017, ndërsa rombet e zinj përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me pritshmëritë për shitjet në 6 muajorin e dytë të vitit 2017.

Përsa i përket rezultatit financiar (Grafiku 4), gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2017, 50% e ndërmarrjeve pohojnë se ai është ulur, 39% shprehen se ka mbetur i pandryshuar dhe 11% shprehen se rezultati financiar është rritur. Ndërsa gjatë gjashtëmuajorit të dytë të 2017, 43% e ndërmarrjeve presin që rezultati financiar të mbetet i pandryshuar, 40% e tyre presin rritje të rezultatit financiar dhe 18% presin që rezultati financiar të ulet.

Grafiku 4. Si ka ndryshuar rezultati financiar i ndërmarrjeve mikro në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 dhe si priten të ndryshojnë në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017*



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikore, Qershor 2017. Ndërmarrjet janë pyetur se si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit, si dhe si presin të ndryshojnë në 6 muajt e ardhshëm. (1 alternativë) 1. Janë rritur (Do të rriten); 2. Janë ulur (Do të ulen); 3. Nuk kanë ndryshuar (Nuk do të ndryshojnë).

*Kolonat e gjelbra përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me rezultatit financiar në 6 muajorin e parë të vitit 2017, ndërsa rombet e zinj përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me pritshmëritë për rezultatit financiar në 6 muajorin e dytë të vitit 2017.

Në lidhje me zgjerimin (apo jo) të aktivitetit (apo të investimeve) paraqitur në Grafikon 5, 83% e ndërmarrjeve pohojnë se as nuk e kanë ndryshuar aktivitetin (apo investimet) gjatë gjashtëmujorit të parë të 2017 dhe as nuk presin që do të ndryshojë gjatë gjashtëmujorit në vazhdim.

Grafik 5. Si kanë ndryshuar veprimtaria apo investimet e ndërmarrjeve mikro në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, dhe si pritet të ndryshojnë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017*



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikore, Qershor 2017. Ndërmarrjet janë pyetur se si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit, si dhe si presin të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm. (1 alternativë) 1. Janë rritur (Do të rriten); 2. Janë ulur (Do të ulen); 3. Nuk kanë ndryshuar (Nuk do të ndryshojnë).


*Kolonat e gjelbra përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me veprimtarinë e ndërmarrjeve në 6 muajin e parë të vitit 2017. Ndërsa rombët e zinj përfaqësojnë përgjigjet në lidhje me pritshmëritë për veprimtarinë në 6 muajin e dytë të vitit 2017.

Për të evidentuar problematikën kryesore të hasur në aktivitetin e tyre gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, subjekteve iu kërkua të klasifikojnë vështirësitë që ato kanë hasur lidhur me disa tipare që janë: aksesin në financim, koston e financimit, disponueshmëria e stafit të kualifikuar, koston e prodhimit ose të punës, konkurrencën, gjetjen e tregut, përshtatshmëria e legjislacionit në fuqi apo të tjera veç këtyre. Subjektet vlerësuan me notat nga një (shkalla më e ulët e vështirësisë) deri në dhjetë (shkalla më e lartë e vështirësisë) problemet e sipërpërmendura.

Ndërmarrjet mikro evidentojnë se konkurrenca, probleme të tjera⁴ dhe gjetja e tregut janë ndër problemet kryesore me të cilat ato janë përballur në gjashtëmujorin e parë të 2017 (Grafiku 6). Vlerësimet e paraqitura në figurën e mëposhtme tregojnë se aksesin dhe kostoja e financimit janë gjithashtu një pengesë e rëndësishme të vlerësuar nga ana e tyre. Ndërsa disponueshmëria e stafit të kualifikuar duket se nuk përbën një problem për ta.

⁴ Të tjera u referohen borxheve të pashlyera nga klientët, tregut informal, papunësia, etj.


Grafik 6. Vlerësimi i problemeve kryesore të ndërmarrjeve mikro gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikore, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet u pyetën se sa të rëndësishme kanë qenë problemet e mëposhtme në gjashtëmuajorin e kaluar, duke vlerësuar shkallën e vështirësisë nga 1 (më e ulët) në 10 (më e lartë).

Në lidhje me burimet kryesore të financimit, rezultatet e vërtetimit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 treguan që 75% e ndërmarrjeve mikro përdorin të ardhurat nga shitjet si burim kryesor të financimit. Burimi i dytë i financimit janë rezervat e mbartura apo shtesat e kapitalit, pohuar nga 18% e ndërmarrjeve, dhe vetëm 7% e tyre pohojnë se kanë përdorur huanë si mjet për të financuar veprimtarinë e biznesit gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017.

Grafik 7. Burimet kryesore të financimit të ndërmarrjeve mikro




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikore, Qershor 2017.
Shënim: Pyetja që u drejtohet ndërmarrjeve është: Si e keni financuar veprimtarinë e biznesit tuaj në 6 muaj e fundit?
1. Nga shitjet; 2. Nga rezervat e mbartura; 3. Huaja; 4. Tjetër (më shumë se një alternativë).

2.2 HUAJA DHE PËRDORIMI I SAJ

Ndërmarrjet mikro u pyetën nëse kishin apo jo një hua për të paguar në periudhën kur u bë vrojtimi. Të dhënat e marra tregojnë që nga 2,304 ndërmarrjeve mikro (1-4 të punësuar) vetëm 26% kanë aktualisht një hua për të shlyer, ndërsa 74% e tyre pohojnë që nuk kanë një të tillë.

Grafik 8. Përqindja e ndërmarrjeve mikro që kanë ose jo një hua për të paguar




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Pyetja që u drejtohet ndërmarrjeve është: A keni aktualisht hua për të paguar? (Po ose Jo, një alternativë)

Në vazhdim, ndërmarrjet të cilat kanë marrë një hua janë pyetur se ku e kanë marrë huanë, si dhe me çfarë kushtesh e kanë marrë atë. Subjektet që kanë marrë hua raportojnë se pjesa më e madhe e tyre (65% e ndërmarrjeve) kanë marrë hua kryesisht në 6 - 12 muajt e fundit, ndërsa vetëm një e treta e tyre në 1- 5 vitet e fundit. Ndërsa 7% e ndërmarrjeve mikro kanë marrë hua para më shumë se 5 vitesh (Grafiku 9).

Të dhënat e paraqitura në Grafikon 10 tregojnë se këto ndërmarrje kanë marrë hua kryesisht nga bankat (53% e ndërmarrjeve) dhe nga personat fizikë (34% e ndërmarrjeve). Ndërsa burime të tjera të financimit kanë peshë relativisht të vogël (Grafiku 10).


Grafik 9. Periudha e marrjes së huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjeve që kanë marrë hua u është drejtuar pyetja: Kur e keni marrë huanë?
(1 ose më shumë se një alternativë)


Ndërmarrjet pohojnë se kryesisht huanë e kanë marrë për të përballuar shpenzimet korrente, si dhe për të kryer një investim afatgjatë. Ndërsa për të shlyer një hua të vjetër dhe për arsye të tjera është përdoret relativisht pak (Grafiku 11).

Grafik 10. Burimi i fondeve të huasë së marrë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjeve që kanë marrë hua u është drejtuar pyetja: Nga e keni marrë huanë?
(një ose më shumë alternativa)


Grafiku 11. Qëllimi i përdorimit të huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017. Shënim: Ndërmarrjeve që kanë marrë hua u është drejtuar pyetja: Cili është qëllimi i përdorimit të huasë (zgjidh më shumë se një alternativë? Përgjigjet janë dhënë në përqindje ndaj totalit të ndërmarrjeve që janë shprehur se kanë aktualisht një hua për të paguar.

Ndërmarrjet të cilat kanë marrë një hua për të financuar veprimtarinë e tyre janë pyetur për të dhënë një vlerësim, gjykim nëse sasia e huasë së marrë ka qenë ose jo e përshtatshme. Vlerësimet tregojnë se 58% e ndërmarrjeve që kanë marrë një hua deklarojnë se huaja është e përshtatshme, 22% e ndërmarrjeve deklarojnë se do të merrnin më pak dhe 19% e tyre deklarojnë se do të donin të merrnin më shumë (Grafiku 12).


Grafiku 12. Si konsiderohet huaja e marrë nga ndërmarrjet që e kanë marrë atë?



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017. Shënim: Pyetja drejtuar ndërmarrjeve është: Nëse keni marrë një hua për të financuar veprimtarinë, si e konsideroni? (referojuni huasë ekzistuese më të madhe të ndërmarrjes-tretho vetëm një) 1. Të përshtatshme; 2. Do të doja të merrja më shumë; 3. Do të doja të merrja më pak.


Rreth 67% e ndërmarrjeve mikro shprehen se huanë e marrë do ta shlyejnë brenda 3 viteve të ardhshme, që tregon se kredia është marrë kryesisht me afat të shkurtër maturimi. Ndërsa për pjesën e mbetur të ndërmarrjeve, 13% e tyre, shprehen se do ta shlyejnë brenda 3-5 viteve, dhe 19% të ndërmarrjeve presin që të përfundojnë shlyerjen e huasë mbas 5 vitesh (Grafiku 13). Përgjithësisht pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (83% e tyre) shprehen se kanë marrë hua me një normë interesi që është e pandryshueshme deri në fund të afatit të maturimit të huasë. Vetëm një pjesë e vogël e ndërmarrjeve shprehen se kanë një hua me normë interesi të luhatshme (Grafiku 14).

Grafik 13. Koha e mbetur për të shlyer të gjithë vlerën e huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur: Edhe sa kohë duhet për të shlyer të gjithë vlerën e huasë (afati maksimal-rretho vetëm një)? 1. Deri në 6 muaj; 2. 6-12 muaj; 3. 1-3 vjet; 4. 3-5 vjet; 5. Mbi 5 vjet.


Grafik 14. Përcaktimi i normës së interesit në kontratën e huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se si është përcaktuar norma e interesit e të huasë më të madhe ekzistuese? (një alternativë) 1. E pandryshueshme deri në fund të afatit; 2. Mund të ndryshojë çdo 3 muaj; 3. Mund të ndryshojë çdo 6 muaj; 4. Mund të ndryshojë çdo vit; 5. Tjetër.


Afërsisht 70% e ndërmarrjeve mikro pohojnë që e shlyejnë huanë çdo muaj, 11% çdo tre muaj, ndërsa pjesa e mbetur e ndërmarrjeve e shlyejnë çdo 6 apo 12 muaj (Grafiku 15).

Grafik 15. Frekuenca e shlyerjes së huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Sa shpesh e shlyeni huanë? (një alternativë) 1. Çdo muaj; 2. Çdo 3 muaj; 3. Çdo 6 muaj; 4. Çdo 12 muaj; 5. Tjetër.

Grafik 16. Kolaterali i vendosur për marrjen e huasë




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Cili është kolaterali që keni vendosur për përfitimin e huasë? (një ose më shumë alternativa) 1. Nuk ka; 2. Pasuri e paluajtshme; 3. Dorëzani; 4. Mjete financiare; 5. Të tjera (makineri, pajisje).

Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë lloj kolateralit kanë vendosur për të përfituar huanë. 57% e ndërmarrjeve pohojnë që nuk kanë vendosur kolateral për të marrë hua, 34% e ndërmarrjeve pohojnë se kanë lënë si garanci një pasuri të paluajtshme dhe 9% e

ndërmarrjeve pohojnë se kanë marrë hua me dorëzani. Garancitë e tjera si: mjete financiare, makineri apo pajisje; janë përdor më pak si kolateral për marrjen e huasë (Grafiku 16).

49% e ndërmarrjeve që kanë deklaruar se kanë vendosur një kolateral për marrjen e kredisë pohojnë që vlera e kolateralit tejkalon mbi 100% të vlerës së huasë, ndërsa 51% e ndërmarrjeve kanë pohuar se vlera e kolateralit është nën 100% të vlerës së huasë (Grafiku 17).




Në lidhje me barrën apo koston e huasë në raport me të ardhurat, 55% e ndërmarrjeve pohojnë se barra e huasë është sa 20% e totalit të të ardhurave dhe për 33% e ndërmarrjeve barra e huasë luhet në nivelin e 20-50% të të ardhurave. Ndërsa për 12% të ndërmarrjeve, barra e huasë luhet në segmentin 50 deri mbi 80% të të ardhurave totale të ndërmarrjeve (Grafiku 18).

Pagesa e huasë për 86% të ndërmarrjeve nuk ka ndryshuar gjatë 6 muajve të parë të vitit 2017 (Grafiku 19). Vetëm 11% e ndërmarrjeve kanë pohuar se shpenzimet për pagesën e huasë janë rritur. Kjo rritje e pagesës së huasë sipas opinionit të ndërmarrjeve ka ardhur kryesisht nga rënia e të ardhurave të siguruara nga biznesi (60%) dhe nga rritja e normës së interesit (38%). Ndërsa ulja e


pagesës së huasë ka ardhur si rezultat i ristrukturimit të kredisë, uljes së normës së interesit dhe rritjes së të ardhurave nga veprimtaria e biznesit të tij (Grafiku 19).

Grafik 18. Barra e huasë ndaj totalit të të ardhurave



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet u pyetën se sa kanë paguar për huanë ndaj totalit të të ardhurave në 6 muajt e kaluar? (një alternativë) 1. Deri në 20% të të ardhurave; 2. 20-50% të të ardhurave; 3. 50-80% të të ardhurave; 4. Mbi 80% të të ardhurave.



Grafik 19. Ndryshimi i pagesës së huasë



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë ndryshuar shpenzimet për pagesën e huasë gjatë 6 muajve të kaluar, cili ka qenë shkaku?

Ndërmarrjet janë pyetur se si e kanë përballuar këtë rritje të kostos së shërbimit të huasë, për të parë nëse kjo rritje u është faturuar konsumatorëve, është bërë në kurriz të fitimeve ose të veprimtarisë së tyre, apo drejt ndryshimit të modelit të biznesit. Rezultatet e


paraqitura në grafikun e mëposhtëm tregojnë se ndërmarrjet, për të përballuar kostot më të larta të shërbimit të huasë, kryesisht kanë ulur shpenzimet e tjera, ose kanë përdorur rezerva të ndryshme për të përballuar koston shtesë (Grafik 20).



Përveç vlerësimit të situatës aktuale të huasë, ndërmarrjet janë pyetur edhe në lidhje me pritjet e tyre mbi pagesën e borxhit

gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017 (Grafiku 21). Rezultatet e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë që 81% e ndërmarrjeve nuk presin që pagesa totale e këstit të huasë të ndryshojë.


Ndërsa në lidhje me vlerësimin e tyre për ngarkesën e huasë (Grafiku 22), 47% e ndërmarrjeve mendojnë që ngarkesa e borxhit është në nivelin mesatar dhe 43% e mendojnë që është lartë. Vetëm 9% e ndërmarrjeve mendojnë që kjo ngarkesë borxhi është relativisht e ulët.



2.3 MARRËDHËNIET E NDËRMARRJEVE ME BANKAT DHE PRITSHMËRITË E TYRE PËR TË ARDHMEN

Në këtë pjesë pasqyrohen rezultatet e marra në lidhje me vlerësimin që kanë ndërmarrjet për marrëdhënien aktuale me bankat, si dhe pritshmëritë e tyre për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017. Rezultatet e marra tregojnë që 94% e ndërmarrjeve nuk kanë aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmujorin e fundit, përkundëjt 6% të ndërmarrjeve që kanë aplikuar për financim (Grafiku 23).


Grafik 23. Përqindjet e ndërmarrjeve mbi aplikimin apo jo të ndonjë forme financimi gjatë gjashtëmuorit të fundit



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: A keni aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmuorin e fundit?

Ndër arsyet kryesore të mos aplikimit për financim (Grafiku 24), 50% e ndërmarrjet përmendin që nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë e tyre, 28% e ndërmarrjeve i duket proces i vështirë dhe 18% e ndërmarrjeve e kanë më të lehtë për të marrë hua nga burime të tjera.


Grafiku 24. Arsyet kryesore për mosaplikimin për financim




Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar janë pyetur se cilat janë arsyet e mosaplikimit duke zgjedhur alternativën e mëposhtme. 1. Nuk e kam të nevojshme për veprimtarinë që kryej; 2. Më duket proces i vështirë; 3. Mendoj që kërkesa ime nuk miratohet; 4. E kam më të lehtë të marr hua nga burime alternative.

Ndërmarrjet të cilat kanë aplikuar për hua (kredi) janë pyetur nëse kërkesa e tyre është miratuar. Rezultatet e vërtetimit treguan që


vetëm 46% e kërkesave për hua janë miratuar, ndërsa 48% e tyre nuk janë miratuar (Grafiku 25).



Të pyetur se si do të vepronin ndërmarrjet nëse nuk do të financoheshin nga bankat (Grafiku 26), 57% e tyre kanë pohuar se do të marrin hua nga burime alternative, 25% pohuan se do të shtynin në kohë planet për zgjerim të veprimtarisë dhe 16% mendonin të kërkonin hua në një bankë apo institucion tjetër.




Subjekteve iu kërkua të vlerësonin procesin e marrjes së huasë nga ana e tyre në banka, duke vlerësuar me nota nga 1 deri në 5, ku 1 procesi i marrjes së huasë është shumë i lehtë dhe 5 është i pamundur. Rezultatet e marra tregojnë që 61% e ndërmarrjeve vlerësojnë se në përgjithësi procesi i marrjes së një huaje nga bankat është i vështirë ose shumë i vështirë, ndërsa 7% e ndërmarrjeve mendojnë se ky proces është i pamundur. Vetëm një e treta e të gjitha ndërmarrjeve mikro e vlerësojnë procesin e marrjes së kredisë si normal dhe të thjeshtë (Grafiku 27).



Gjithashtu, nga ndërmarrjet u kërkua të jepnin një vlerësim për secilin element që ndikon në marrëdhënien e tyre me bankat. Rezultatet e marra tregojnë që 80% e ndërmarrjeve pohojnë se një element i rëndësishëm që vështirëson këtë marrëdhënie është se kredia në përgjithësi është e shtrenjtë, ka kosto të lartë financiare për të plotësuar kërkesat e bankës, si dhe kushtet e garantimit të kredisë janë të paarsyeshme (Grafiku 28).


Grafik 28. Perceptimi i ndërmarrjeve mbi marrëdhënien me bankat



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet pyeten se cili element paraqet vështirësi për ndërmarrjen në përfitimim e një kredisë nga bankat, (nga 1 deri në 5, nga shkalla më e ulët tek shkalla më e lartë e vështirësisë, për secilën alternativë më sipër).

Të pyetur mbi mundësinë për të marrë një kredi bankare gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017, 60% e tyre vlerësojnë se nuk kanë asnjë mundësi për të marrë kredi dhe 35% vlerësojnë se ka pak mundësi. Vetëm 6% parashikojnë që të marrin një kredi bankare gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2017 (Grafiku 29).


Grafik 29. Mundësia që ndërmarrja të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se sa është mundësia që të marrin një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm, duke zgjedhur vetëm një alternativë. 1. Nuk ka asnjë mundësi; 2. Ka pak mundësi; 3. Ka shumë mundësi; 4. Është e sigurt.

Pavarësisht se ndërmarrjet vlerësojnë se kredia dhe kostoja e marrjes së kredisë është e lartë, rreth 60% e totalit të ndërmarrjeve mikro e konsiderojnë të domosdoshme dhe të rëndësishme marrëdhënien me bankat për ecurinë e veprimtarisë së tyre (Grafiku 30).

Grafik 30. Rëndësia e marrëdhënieve së bankës për ecurinë e veprimtarisë së ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro, Qershor 2017.
Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur sa të rëndësishme do t'i konsideronin marrëdhëniet me bankat për ecurinë e veprimtarisë së kompanisë së tyre? (1 alternativë) 1. Të domosdoshme; 2. Të rëndësishme, 3. Jo dhe aq të rëndësishme.

SHTOJCA 1.

PYETËSOR MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE TE VOGLA

Indikatori i përgjigjes 1. përgjigjur 2. refuzuar 3. pa kontakt 4. pasive (fjetur) 5. mbyllur (çregjistruar) 6. jashtë qëllimit

RUBRIKA I. ORGANIZIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

P1. Sa % të produkteve tuaja shiten brenda vendit?
(rretho vetëm një)

- | | |
|----------------|------------|
| 1. Deri në 20% | 3. 50-80% |
| 2. 20-50% | 4. Mbi 80% |

P2. Sa të rëndësishme kanë qenë problemet e mëposhtme në gjashtëmujorin e kaluar për ndërmarrjen tuaj, ku 1- shkalla më e ulët e vështirësisë dhe 10- shkalla më e lartë e vështirësisë. (Plotëso secilën alternativë)

1. Aksesi në financim _____
2. Kosto e financimit _____
3. Disponueshmëria e stafit të kualifikuar _____
4. Kosto e prodhimit ose e punës _____
5. Konkurrenca _____
6. Gjetja e tregut _____
7. Përshtatshmëria e legjislacionit në fuqi _____
8. Të tjera _____ (përcakto) _____

RUBRIKA II. ECURIA FINANCIARE E NDËRMARRJES DHE PRANIA E HUASË

P3. Në cilën monedhë e kryeni veprimtarinë e biznesit?
(përcakto përafërsisht % që zënë veprimet sipas monedhave të ndryshme në totalin e veprimtarisë së biznesit)

Lekë ___%

Euro ___%

Usd ___%

Tjetër _____ (përcakto) ___%

P4. a) Si kanë ndryshuar shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (rretho vetëm një)

1. Janë rritur
2. Janë ulur
3. Nuk kanë ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojnë shitjet në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një)

1. Do të rriten
2. Do të ulen
3. Nuk do të ndryshojnë

P5. Sa rezultuan shitjet e përgjithshme në 6 muajt e fundit? (në Lekë të reja) _____ lekë

P6. a) Si ka ndryshuar rezultati financiar në 6 muajt e fundit?
(rretho vetëm një)

1. Është rritur
2. Është ulur
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një):

1. Do të rritet
2. Do të ulet
3. Nuk do të ndryshojë

P7. Sa ishte rezultati financiar i biznesit tuaj në 6 muajt e fundit, në lekë (të reja)? (zgjidh vetëm një alternativë)

Fitim: _____lekë (të reja)

Humbje: _____lekë (të reja)

P8. a) A e keni zgjeruar veprimtarinë/rritur investimet në 6 muajt e fundit? (rretho vetëm një)

1. Është zgjeruar
2. Është ngushtuar
3. Nuk ka ndryshuar

b) Si prisni të ndryshojë në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një):

1. Do të zgjerohet
2. Do të ngushtohet
3. Nuk do të ndryshojë

P9. Si e keni financuar veprimtarinë e biznesit tuaj në 6 muajt e fundit? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë)

1. Nga shitjet _____%
2. Nga rezervat e mbartura/rritja e kapitalit _____%
3. Hua _____%
4. Tjetër _____(përcakto) _____%

P10. A keni aktualisht hua për të paguar? (rretho vetëm një)

Po (nëse po, vazhdoni në pyetjen 11)

Jo (nëse jo, vazhdoni në pyetjen 25)

P11. Kur e keni marrë huanë? (mund të zgjidhet më shumë se një alternativë)

1. 6 muajt e fundit ____nr. i huave
2. Vitin e fundit ____nr. i huave
3. 1-5 vitet e fundit ____nr. i huave
4. Para më shumë se 5 vitesh ____nr. i huave

P12. Nga e keni marrë huanë (huatë) dhe me çfarë norme interesi (në %)? (mund të zgjidhet një ose më shumë alternativa)

	Huamarrje në:	(A) Nr. i huave	(B) Norma e interesit (%)	(C) Vlera e huasë	(D) Monedha e huasë
1	Bankë				
2	Institucion financiar jobankë				
3	Person fizik				
4	Kompani të tjera				
5	Mall i papaguar				
6	Tjetër (specifiko) _____				

P13. Cili është qëllimi i përdorimit të huasë? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë)

1. Për të përballuar shpenzime korrente
2. Për të shlyer një hua më të vjetër
3. Për të kryer një investim afatgjatë
4. Tjetër _____ (përcakto)

P14. Nëse keni marrë hua për të financuar veprimtarinë, si e konsideroni atë? (referojuni huasë ekzistuese më të madhe të ndërmarrjes - rretho vetëm një)

1. Të përshtatshme
2. Do të doja të merrja më SHUMË
3. Do të doja të merrja më PAK

RUBRIKA III. STRUKTURA E HUASË

P15. Edhe sa kohë duhet për të shlyer të gjithë vlerën e huasë?
(afati maksimal - rretho vetëm një)

1. Deri në 6 muaj
2. 6-12 muaj
3. 1-3 vjet
4. 3-5 vjet
5. Mbi 5 vjet

P16. Si është përcaktuar norma e interesit të huasë më të madhe ekzistuese? (rretho vetëm një)

1. E pandryshueshme deri në fund të afatit
2. Mund të ndryshojë çdo 3 muaj
3. Mund të ndryshojë çdo 6 muaj
4. Mund të ndryshojë çdo vit
5. Tjetër _____ (përcakto)

P17. Sa shpesh e shlyeni huanë? (rretho vetëm një)

1. Çdo muaj
2. Çdo 3 muaj
3. Çdo 6 muaj
4. Çdo 12 muaj
5. Tjetër

P18. Cili është kolaterali që keni vendosur për përfitimin e huasë? (mund të rrethohen më shumë se një alternativë)

1. Nuk ka ____nr. i huave
2. Pasuri e paluajtshme ____nr. i huave
3. Mjete financiare ____nr. i huave
4. Dorëzani, garanci ____nr. i huave
5. Të tjera _____ (përcakto) ____nr. i huave

P19. Në rast të përdorimit të kolateralit, cila është vlera totale e tij në raport me totalin e huasë të kolateralizuar? (rretho vetëm një)

1. Deri në 50% e vlerës së huasë
2. 50-100% e vlerës së huasë
3. 100-120% e vlerës së huasë
4. Mbi 120% e vlerës së huasë

RUBRIKA IV. NGARKESA E HUASË

P20. Në 6 muajt e kaluar, sa keni paguar për huanë ndaj totalit të të ardhurave? (rretho vetëm një)

1. Deri në 20% të të ardhurave
2. 20-50% të të ardhurave
3. 50-80% të të ardhurave
4. Mbi 80% të të ardhurave

P21. Nëse ka ndryshuar shpenzimi për pagesën e huasë gjatë 6 muajve të kaluar, cili ka qenë shkaku?

	Mund të zgjidhen disa alternativa	Mund të zgjidhen disa alternativa
1. Nuk ka ndryshuar	2. Është rritur, sepse: 2.1 është rritur norma e interesit; 2.2 janë shtuar kërkesa të tjera nga huadhënësi; 2.3 kanë rënë të ardhurat nga veprimtaria e biznesit; 2.4 të tjera _____(përcakto).	3. Është ulur, sepse: 3.1 është ulur norma e interesit; 3.2 është ulur vlera periodike e pagesës së huasë (p.sh. është ristrukturuar kredia); 3.3 ka ndryshuar forma e pagesës së huasë, duke i shtyrë detyrimet periodike; 3.4 janë rritur të ardhurat nga veprimtaria e biznesit; 3.5 të tjera ____përcakto____.

P22. Nëse kostoja e shërbimit të huasë është rritur, si keni vepruar për të përballuar këtë rritje? (mund të rrethohet më shumë se një alternativë)

1. Janë rritur çmimet e produkteve që u shiten klientëve
2. Është shitur një pjesë e veprimtarisë së ndërmarrjes
3. Janë ulur shpenzimet e tjera
4. Janë përdorur rezerva të ndryshme
5. Është orientuar veprimtaria e ndërmarrjes drejt një fushë veprimi më fitimprurëse
6. Tjetër _____ (përcakto)

P23. Si prisni të ndryshojë pagesa totale e këstit të huasë në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një)

1. Nuk do të ndryshojë
2. Do të rriten
3. Do të ulen

P24. Si e vlerësoni në përgjithësi ngarkesën e borxhit?

1. E lartë
2. Mesatare
3. E ulët

RUBRIKA V. MARRËDHËNIA ME BANKAT DHE PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN (REFERUAR EDHE BIZNESEVE JOHUAMARRËSE)

P25. A keni aplikuar për ndonjë formë financimi në gjashtëmuajorin e fundit?

1. Po, kam aplikuar (vijo me tabelën):

1.1 Kërkesa ime është miratuar:	1.2 Kërkesa ime nuk është miratuar:
1.1.1 Është ristrukturuar huaja ekzistuese	1.2.1 Është në proces
1.1.2 Kam marrë hua të re:	1.2.2 Nuk plotësoja kushtet e bankës
1.1.2.1 deri në 75% të vlerës së kërkuar;	1.2.2.1 Nuk kisha aftësi paguese
1.1.2.2 mbi 75% të vlerës së kërkuar.	1.2.2.2 Projekti nuk ishte bindës
	1.2.2.3 Nuk kisha kolateral të mjaftueshëm
	1.2.2.4 Tjetër (specifik)_____

2. Jo, nuk kam aplikuar sepse:

- 2.1 nuk e kam të nevojshme për veprimtarinë që kryej;
- 2.2 në duket proces i vështirë;
- 2.3 mendoj që kërkesa ime nuk miratohet;
- 2.4 e kam më të lehtë të marr hua nga burime alternative.

P26. Si do të veproni nëse nuk financoheni nga banka?

1. Do të kërkoj në një bankë/institucion tjetër
2. Do të shtyj në kohë planet për zgjerim të veprimtarisë
3. Do të marr hua nga burime alternative

P27. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit procesin e marrjes së një huaje nga bankat në vend, në këto 6 muajt e fundit? (rretho vetëm një)

1. Shumë të thjeshtë
2. Normal
3. Të vështirë
4. Shumë të vështirë
5. Pothuaj të pamundur

P28. Plotësoni elementet e mëposhtme me shifrat nga 1 në 5, sipas vështirësisë që secili element paraqet për ndërmarrjen tuaj, në përfitimin e një kredie bankare, ku 1- shkalla më e ulët e vështirësisë dhe 5- shkalla më e lartë e vështirësisë. (Plotëso secilën alternativë)

1. Paqartësi e kërkesave të bankës dhe procedura burokratike___
2. Kostoja e lartë financiare për të plotësuar kërkesat e bankës___
3. Kushtet për garantimin e kredisë janë të paarsyeshme ___
4. Procedura e miratimit të kredisë nuk është transparente ___
5. Kredia në përgjithësi është e shtrenjtë___
6. Struktura e kredisë, nuk i përshtatet ciklit të veprimitarisë së biznesit___
7. Gjatë jetës së kredisë, kushtet e saj ndryshohen në mënyrë jotransparente nga banka___
8. Nuk ekziston fleksibiliteti i nevojshëm midis bankës dhe kredimarrësit, për mënyrën e strukturimit dhe shlyerjen e kredisë___
9. Biznesi nuk arrin të plotësojë kërkesat normale të bankës për të marrë një kredi___

P29. Sa është mundësia që ndërmarrja juaj të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm? (rretho vetëm një)

1. Nuk ka asnjë mundësi
2. Ka pak mundësi
3. Ka shumë mundësi
4. Është e sigurt

P30. Sa të rëndësishme do t'i konsideronit marrëdhëniet me bankat për ecurinë e veprimitarisë së kompanisë suaj? (rretho vetëm një)

1. Të domosdoshme
2. Të rëndësishme
3. Jo dhe aq të rëndësishme

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Ceca, Kliti

Rezultatet e vërtetimit të situatës financiare dhe huamarrëse të ndërmarrjeve mikro në Shqipëri : material studimor : (raport statistikor, Janar 2018) / Kliti Ceca, Elona Dushku.

– Tiranë : Banka e Shqipërisë, 2019

44 f. : me il. ; 21X15 cm.

ISBN 978-9928-262-20-2

I.Dushku, Elona

1.Banka dhe veprimtaria bankare 2.Ndërmarrje
të biznesit 3.Hua 4.Shqipëri

336.717.5(496.5)

ISBN 978-9928-262-20-2



www.bankofalbania.org

ISBN 978-9928-262-20-2



9 789928 262202 >